



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 22.12. 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë, Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë, Anton Quni, Qerim Bajrami, Ganimete Musliu dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj, Rexhep Selimi dhe Zafir Berisha.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Lulzim Peci dhe Blend Zyrap-KIPRED; Sanije Berisha-OSBE; Luanda Domi-DCAF dhe Plator Avdiu-QKSS.

Mbledhjen e kryesoi, Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të datës 4.11.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04 /L-076 për Policinë;
4. Realizimi vjetor i Planit të punës së Komisionit;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të datës 4.11.2015

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë

Kryesuesi theksoi se për këtë çështje Komisioni dhe grupi punues ka realizuar një sërë aktivitete dhe sot do të prezantohet raporti me rekomandime. Fjalën ia dha referuesit të grupit punues, z.Nuredin Ibishi, që të prezantojë raportin me rekomandime.

Nuredin Ibishi, theksoi se grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë, ka bërë mbikëqyrjen e këtij ligji ku janë marrë një sërë aktivitete, si: vizita në terren, dëgjime publike dhe është dalë me rekomandime.

Më tutje, theksoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit, realizoi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, ku në mbledhjen e mbajtur më 22 dhjetor 2015, vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin me rekomandime për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë, si vijon:

1. Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës dhe Inspektorati Policor i Kosovës, në vazhdimësi duhet të ngritin kapacitetet dhe nivelin e mbikëqyrjes dhe bashkëpunimit në kryerjen e detyrave dhe autorizimeve ligjore. Zyrtarët policorë, në vazhdimësi duhet të zbatojnë detyrat dhe autorizimet policore në mënyrë të ligjshme, sipas dispozitave të Kushtetutës së Kosovës, ligjeve të tjera në fuqi, të këtij ligji, akteve nënligjore, parimeve dhe standardeve operative, Kodit të Etikës së Policisë së Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare të zbatueseve të ligjit.
2. Zyrtarët policorë duhet të përfshihen në programe të certifikuara edukimi dhe trajnimi të njohjes dhe zbatimit të dispozitave të parapara me ligjet në fuqi, lidhur me mënyrën e kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore, në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, sipas parimit të legjitimitetit, përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit.
3. Në kuadër të kompetencave të MPB-së, me memorandume, marrëveshje apo akteve të tjera të bashkëpunimit, të funksionalizohen dhe fuqizohen marrëdhëniet në mes të Policisë dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit në Kosovë, si dhe Prokurorisë dhe gjykatës. Me qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet

policisë, prokurorit publik dhe gjykatës, duhet të bëhet sistemi i integruar i shfrytëzimit të evidencave nga baza e të dhënave të këtyre institucioneve.

4. Të zbatohen dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me kontrollin parandalues, sipas nenit 22 të ligjit.
5. Të shqyrtohet mundësia për themelimin e Policisë Gjyqësore, me qëllim të rritjes së efikasitetin në kryerjen e hetimit të veprave penale nga policia me synim të sigurimit të pavarësisë në hetimet penale.
6. Qeveria duhet të procedojë Projektligjin për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policorë duke zotuar mjetet buxhetore, me qëllimin të përmirësimit të kuotës së moshës së zyrtarëve policorë, që tash është me mesatare prej 43 vjeç.
7. Të ndërmerren masat e nevojshme ligjore dhe administrative (konfiskimin e përkohshëm të dokumenteve personale, si garanci për realizimin e dënimeve mandatore të shqiptuar nga policia dhe gjykatat) për të përmirësuar situatën e rëndë të sigurisë në komunikacionin rrugor, me trend të lartë të aksidenteve në trafik me pasoja të fatalitetit-vdekjes dhe dëmeve të mëdha materiale.
8. Të bëhet reformimi në sistemin e gradimit, ku përveç dy gradave të para, polic i ri dhe polic, avancimi në gradat e tjera është i paafatizuar dhe është në vartësi të nevojave të shërbimit për gradën e caktuar. Si kriter shtesë për avancim në sistemit të gradimit duhet të merret për bazë edhe niveli i shkollimit të kryer.
9. Ngritja e vazhdueshme e përfshirjes së femrës në të gjitha strukturat e policisë, si në aspektin e përfaqësimit kuantitativ, po ashtu edhe në vendimmarrje, duke zbatuar dispozitat e ligjeve në fuqi.
10. Të zbatohen dispozitat rreth sigurimit të shtesave, kompensimeve dhe beneficioneve për zyrtarët policorë. Duhet të rregullohet me ligj të veçantë stazhi i beneficuar i punës, sigurimet suplementare me beneficionet shëndetësore, sigurimi social dhe ndihma juridike falas.
11. Të zbatohet testi i integritetit për zyrtarët policorë, sipas modelit të një shteti anëtar i BE-së.
12. Polica, në vazhdimësi, duhet të avancojë punën në funksionalizmin dhe standardizimin e formave dhe metodologjive të punës, si: policimi i udhëhequr nga intelijenca, policimi në komunitet me implementimin e punës në sektorët e sigurisë, patrullimi, mbajtja e rendit dhe qetësisë publike me standardet e përvetësuara të kontrollit të turmave dhe trazirave, në rastet e prishjes së rendit dhe qetësisë publike. Parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit, siguria në trafik, Menaxhimi i Integruar të Kufirit, me funksionalizimin e Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit.
13. Polica të lirohet nga niveli i lartë i aktiviteteve dytësore, si asistencë për shërbime të institucioneve lokale dhe qendrore, si dhe shërbimet e rojeve statike. Policia duhet të përqendrohet në detyrat dhe autorizimet operacionale policore.
14. Polica të ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, lidhur me pasqyrat financiare vjetore rreth shpenzimeve buxhetore dhe rekomandimeve të tjera.
15. Qeveria, përmes ministrive përkatëse të bëjë harmonizimin e dispozitave të Ligjit për policinë, Ligjit për shërbim civil, Ligjin për prokurim publik dhe Ligjit të punës.
16. Me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore të policisë, është i nevojshëm hartimi i projektligjeve: Projektligji për infrastrukturën kritike në Kosovë dhe Projektligji për administrimin e të dhënave forenzike të zyrtarëve të zbatimit të ligjit në Kosovë.

17. MPB-ja dhe Policia e Kosovës duhet të rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar policor dhe Policia e Kosovës të anëtarësohet në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe policisë.

Kryesuesi kërkoi që nëse dikush nga deputetët ka ndonjë çështje për të shtuar, mund të marrë fjalën. Më tutje, hodhi në votim raportin me rekomandime.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04 /L-076 për Policinë dhe i rekomandohet Kuvendit miratimi i tyre.

4. Realizimi vjetor i Planit të punës së Komisionit

Kryesuesi theksoi se lidhur me realizimin e Planit të punës për vitin 2015, është përgatitur raporti i punës. Tutje theksoi që plani i punës është realizuar nga ajo çfarë është paraparë në plan, janë shqyrtuar katër projektligje, është realizuar mbikëqyrja e një ligji, si dhe aktivitete të tjera të cilat janë të pasqyruara në raport. Më pas, hapi diskutimin lidhur me realizimin e Planit të punës.

Anton Quni, theksoi se sa i përket realizimit të Planit të punës, nuk do të ndalet shumë, pasi ai është përpiluar bashkërisht dhe është realizuar si i tillë. Më tutje, tha se do të ndalet tek një specifikë e Komisionit, pasi që për një kohë Komisioni nuk është në përbërje të plotë dhe mungon prezenca e anëtarëve që janë nga opozita, prandaj shfrytëzoj rastin të bëjë një thirrje për kolegët që janë anëtarë të këtij Komisioni, dhe duke marrë parasysh kërcënimet që janë shfaqur së fundmi ndaj shtetit të Kosovës, nga ato që gjenerojnë brenda Kosovës dhe ato që mund të jenë të importuara.

Kur është në pyetje siguria nacionale, dhe si Komision i autorizuar për mbikëqyrjen e legjislacionit në këtë fushë, natyrisht që me mungesën e deputetëve të opozitës, është një hendikep në këtë drejtim. Prandaj, ju bëjë thirrje që në këto rrethana kur është në pyetje siguria nacionale, të gjithë anëtarët duhet të tejkalojnë qëndrimet partiake dhe të jenë pjesë e Komisionit, në mënyrë që të diskutohen shqetësimet.

Në momentet kur atakohet shteti, institucionet e sigurisë janë vija e fundit e mbrojtjes së shtetit.

Qerim Bajrami, përkrahu qëndrimin e z. Anton Quni dhe u bëri thirrje kolegëve nga opozita që të kthehen dhe të kryejmë punën e suksesshme, bashkërisht. Po ashtu, theksoi se ky Komision ka kryer një punë shumë të mirë gjatë këtij viti dhe është punuar mirë, seriozisht dhe me përgjegjësi. Po ashtu, falënderoi për përkrahjen që i është dhënë për plotësim-ndryshimin Ligjit për letërnjoftim, duke shpresuar që edhe vitin e ardhshëm të vazhdohet me të njëjtin ritëm.

Nuredin Ibishi, theksoi se mbështet qëndrimin e kolegëve që t'u bëhet thirrje kolegëve nga opozita, që të japin kontributin në kuadër të Komisionit. Po ashtu, theksoi se sa i përket çështjes së mbikëqyrjes së Këshillit të Sigurisë së Kosovës, theksoi se është një dispozitë e Ligjit për

Këshillin e Sigurisë së Kosovës, i cili nuk e përcakton qartë komisionin që do të bëjë mbikëqyrjen e tij, pasi në ligj i referohet si "komisioni funksional përkatës", pa e përcaktuar cili komision është në pyetje.

Më tutje, theksoi se kjo çështje duhet të rregullohet dhe të ngrihet në nivel të Kryesisë së Kuvendit, që si Komision, të na jepet ky mandat. Çështje tjetër është aspekti i bashkëpunimit të mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë, pasi siguria është çështje e pandashme dhe sidomos për rrethanat e krijuara, ndërsa në vitin e ri të punës, të përcaktojmë një metodologji të re të punë dhe të mbikëqyrjes.

Bojan Mitiq, përkrahu qëndrimin e anëtarëve për t'u bërë thirrje anëtarëve të Komisionit që janë nga partitë opozitare, që të marrin pjesë në mbledhje, në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira. Po ashtu, përkrah raportin për realizimin e Planit të punës për vitin 2015.

5. Të ndryshme

Kryesuesi kërkoi që nëse nuk ka çështje për t'u ngritur, ftoi që pjesëmarrësit në Konferencën Rajonale në Beograd, nga data 25-26 nëntor 2015, të paraqesin njoftimin lidhur me këtë pjesëmarrje. Fjalën ia dha z. Bojan Mitiq.

Bojan Mitiq, lidhur me pjesëmarrjen në Konferencën Rajonale mbi Menaxhimin e Migracionit, mbrojtjen e refugjatëve dhe luftën kundër krimit të organizuar-përgjigjet kombëtare dhe bashkëpunimi rajonal, e mbajtur në Beograd nga data 26-27 nëntor 2015, tha se prezentë kanë qenë nëntë vende të rajonit dhe është diskutuar për krizën e emigrantëve në rajon dhe se organizator të kësaj konference kanë qenë DCAF dhe Kuvendi i Serbisë.

Më tutje, theksoi se është dinamika e zhvillimeve të fundit në Ballkanin Perëndimor që ka tërhequr nevojën për t'u përballur me këto çështje. Si përfaqësues nga Kosova, kemi marrë pjesë në diskutime, ku pjesëmarrës kemi qenë unë dhe z. Qerim Bajrami.

Ajo çfarë është theksuar, ka qenë përpjekja për luftimin e krimit të organizuar, rritja e masave në nivelin rajonal, po ashtu janë shqyrtuar hapat për koordinimin e hapave qeveritarë të strukturave të sigurisë dhe për qasjen rajonale.

Po ashtu, theksoi se pritja nga organizatorët kanë qenë në nivelin e duhur dhe se pas dy ditëve të konferencës, janë nxjerrë konkluzionet si në vijim:

1. Ruajtja e dialogut politik dhe promovimi i mekanizmave për shkëmbim teknik të informatave dhe bashkëpunimit operacional, që kanë të bëjnë me sfidat aktuale të migrimin në rajon.
2. Koordinimi i përgjigjeve (reagimeve) kombëtare në trajtimin e krizës së refugjatëve në Evropën Juglindore, duke u mbështetur në mësimet e nxjerra prej qasjeve të ndryshme kombëtare.
3. Identifikimi i mangësive dhe problemeve ekzistuese ose potenciale në menaxhimin e kufijve dhe zbatimin e politikave për të adresuar migracionin dhe refugjatët.
4. Të nxisë bashkëpunimin rajonal të agjencive të zbatimit të ligjit në luftën kundër krimit të organizuar, bazuar në proceset dhe nismat ekzistuese.

5. Marrja e masave për të përforcuar mbrojtjen e refugjatëve dhe azilkërkuesve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë për rritjen e sigurisë së këtyre grupeve të cënueshme ndaj trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandës dhe aktiviteteve kriminale të organizuara.
6. Për të lehtësuar bashkëpunimin rajonal të organizatave joqeveritare aktive në fushën e cila ndihmon refugjatët dhe azilkërkuesit.

Në këtë konferencë, nga ana jonë është prezantuar se çfarë ka ndërmarrë Kosova në këtë drejtim, siç është aspekti i hartimit të ligjeve dhe kapaciteti për të pranuar refugjatë. Gjithashtu, është theksuar nevoja për bashkëpunim në të ardhmen, si dhe bashkëpunimi më i fuqishëm i shërbimeve informative për shkëmbimin e informacioneve, si dhe u kërkua nga ne që të kontribuojmë në realizimin e kësaj marrëveshjeje.

Qerim Bajrami, lidhur me pjesëmarrjen në këtë konferencë, theksoi se ka qenë e një rëndësie të veçantë, por fatkeqësisht nuk ka pasur mbulesë nga mediat. Konferenca ka qenë e organizuar shumë mirë dhe jemi pritur mire e jemi trajtuar si delegacion i barabartë me tetë delegacionet e tjera. Siç është parë edhe nga konkluzionet, në fund është thënë se morën pjesë nëntë parlamentet nga vendet e Evropës Juglindore. Po ashtu, falënderoi Marija Obradoviç, kryetare e Komisionit të Mbrojtës dhe Punëve të Brendshme të Asamblesë Parlamentare të Serbisë, e cila na ka prezantuar si delegacion nga Kosova. Më tutje, vlerësoi se edhe në konferenca të tjera të kësaj natyre, të kemi një përvojë të tillë. P ashtu, falënderoi DCAF-in për mbështetjen dhe përkrahjen.

Nuredin Ibishi, theksoi se konferencat rajonale janë të mirëpritura dhe se DCAF-i ka luajtur rol, duke mbështetur Komisionin në këtë drejtim, pasi që kohëve të fundit është paraqitur trendi i zhvillimeve negative në fushën e sigurisë, edhe pse Kosova mund të paraqitet si vend transit ose rasti i migrimit të qytetarëve dhe trajtimit të tyre. Prandaj, vlerësoi që vendi duhet të marrë masa, sidomos në rastet e trafikimit dhe rastet e përfshirjes në grupe terroriste, dhe se bashkëpunimi në nivel rajonal është i nevojshëm.

Kryesuesi, në mbyllje të këtij takimi, falënderoi DCAF-in për organizimin e konferencave të tilla, që trajtojnë sfida për gjithë rajonin. Po ashtu, theksoi se organizime të tilla të barabarta në nivel rajonal, do t'i kontribuojnë sigurisë në rajon dhe në vend.

Gjithashtu, falënderoi organizatat e shoqërisë civile për kontributin e tyre në Komision, si dhe mediat. Me këtë pikë të rendit të ditës, e përfundoi mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku